



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2025

PROCESVERBAL-Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E
SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Rikonstruksioni i shkollës Marigo Posjo”**
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45210000-2;

VLERA E FONDIT LIMIT: **126,775,282.00 (njëqind e njëzet e gjashtë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

b. Sigurimi i Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve në Shtojcën 7 të DST

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet, të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas përcaktimeve të

Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 për kriteret detyruese për skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të çertifikuara nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabel ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabel, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabel përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabel arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabel”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: *62,119,888.18 (gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë .18) lek pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose*

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht : *253,550,564.00 (dyqind e pesëdhjetë e tre milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër) lek pa TVSH.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me :
- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion të deklaruar në organet tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacion përfundimtar;
- Faturat tatimore për këtë situacion të deklaruar në organet tatimore;
- Akt kolaudimi objekti.

Në rastin e bashkimit të operatorëve pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në

bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët Ekonomikë, anëtar të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

- **Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.**
- **Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë 5 (pesë) viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatorit ekonomik ofertues i është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE – së, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni AK ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1, shkronja a) dhe b).

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e*

Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP- 1 A Punime gjurmimi në tokë.

NP- 2 A Ndërtime civile dhe Industriale

NP- 3 C Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godina civile e industriale, veshje fasada

NP-4 A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

NP- 12A Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit

NS- 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve

NS- 2 A Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

NS- 3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

NS- 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS- 12 A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

NS- 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

NS- 18 A Punime topogjeodezike.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i

punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në liçencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve në preventivin e hartuar nga projektuesi pasi aktivitetet kryesore që do të kryejë Kontraktori për përfundimin me sukses të punimeve sipas kontratës në këtë objekt janë:

➤ Mobilizimi

➤ Furnizimi, Transporti dhe Magazinimi i Materialeve

➤ Aktivitetet e Punimeve Ndërtimore

➤ Mbrojtja e Punimeve, ambientit dhe publikut

➤ Kontrolli laboratorik, Testimi dhe Kontrolli i cilesisë së materialeve

Klasat janë përcaktuar referuar Lidhjes 4, të VKM 42/2008, në proporcion me preventivin e punimeve dhe fondin limit dhe janë analizuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve në tabelën si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP – 1	<i>(Punime gjurmimi në tokë.)</i>	Punimet Referuar projektit, preventivit, dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NP – 2	Ndërtime civile dhe Industriale	Punimet Referuar projektit, preventivit, dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit

NP – 3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	C (51 – 100 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NP - 4	(Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.) Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët,, PARKIMET,, SHESHET TË REALIZUARA ME MATERIALE TË VEÇANTA, NATYRALE DHE ARTIFICIALE,....	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NP - 12	Punime të inxhinierisë mjedisore	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NS - 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NS - 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NS - 3	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NS - 4	Punime rifiniture të muraturës dhe	Punimet Referuar projektit,	A (0 – 20 milion lekë	Sipas vlerave të preventivit

	të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	preventivit,dhe specifikimeve teknike	)	
NS - 12	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NS - 14	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj	Punimet Referuar projektit, preventivit,dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit
NS - 18	(Punime topogjeodezike)	Punimet Referuar projektit dhe specifikimeve teknike	A (0 – 20 milion lekë)	Sipas vlerave të preventivit

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) ing. Ndërtimi / Ing Strukturist
- 1 (një) ing. Elektrik
- 1 (një) ing. Hidroteknik
- 1 (një) ing. Mekanik
- 1 (një) ing. Mjedis
- 1 (një) ing Topograf/ Gjeodet/Markshajder

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, diplomë universitare, librezë pune dhe CV

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti

Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Ing. Ndërtimi/ Ing. Strukturist** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
- **Ing. Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë
- **Ing. Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidroteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
- **Ing. Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve hidroteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse.
Duhet patur në konsideratë se projekti për rikonstruksionin e shkollës përfshin punime mekanike ku përfshihen instalimet e ngrohjes dhe ftohjes dhe instalimet e pajisjeve të kondicionimit dhe është e nevojshme që këto punime të kryhen nën kujdesin e Inxhinierit Mekanik.
- **Ing. Mjedisit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve mjedisore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, konkretisht zërave të punimeve që klasifikohen në kategoritë përkatëse. **Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rishikime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat**

dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Fidane Peme dekorative, mbjellje bari ne skarpat, F.V Dhe vegjetal per mbushje (brezat e gjelber) etj.

- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

- 1 (një) ing. Elektronik (automatik) – Operatori Ekonomik duhet të lidhë dhe të paraqas Kontratë Shërbimi në rast se nuk e disponon në listpagesat e kërkuara.

Ky kriter kërkohet referuar punimeve të parashikuara si instalim ashensori, sisteme anti zjarr etj. në preventiv të cilat duhen kontrolluar nga një inxhinier Elektronik

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- 2 (dy) manovratorë të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

- 2 (dy) shofer kamioni të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.)

- 2 (dy) punëtor asfalti të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga ekuivalente me të, kontratë individuale pune si dhe librezë pune (për punimet e asfaltobetonit në shtrimin e sheshit.

- 2 (dy) elektrikist të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- 2 (dy) hidraulik të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

- **1 (një) termo hidraulik** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës. (për instalimin e impianteve)
- **1 (një) elektroteknikë** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës. (për instalimin e sistemeve elektronike si ashensor, sisteme kundrra zjarrit etj)
- **2 (dy) hekurkthyes** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) karpentier dhe/ose betonues** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **2 (dy) Murator dhe/ose Suvaxhi(Suvatues)** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **4 (katër) pllakashtrues** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **4 (katër) bojaxhi** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **1 (një) hidroizolues** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.
- **1 (një) saldator** të vërtetuar me një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/çertifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente si dhe kontratën individuale të punës.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbyshur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit

26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Kategorizimi i profesionit të punonjësve është bërë bazuar në kodet e përcaktuara në VKM 514 datë 15.09.2017, si më poshtë:

3119.15 Teknik ndërtimi (Grup njësi “Teknikë të shkencës së fizikë dhe inxhinierisë të pa klasifikuar diku tjetër” Kodi i profesionit: 3119) *Funksionet kryesore: Teknikët e këtij grupi kryejnë një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës: a) Mbledhin të dhëna dhe japin mbështetje teknike për të kontribuar në përdorimin sa më efikas, të sigurtë dhe ekonomik të burimeve njerëzore dhe materiale, por edhe të pajisjeve. b) Kontribuojnë me anë të komenteve dhe sugjerimeve për vendosjen dhe planimetrinë e linjës së punës duke pasur parasysh procesin e caktuar që zhvillohet. c) Zbatojnë metoda pune dhe një seri veprimesh për të kryer detyrat e caktuara. d) Mbikëqyrin ecurinë dhe vazhdimësinë e metodave dhe planeve të punës së përcaktuar. e) Ndihmojnë në identifikimin e kërcënimeve për sigurinë dhe prezantojnë procedurat dhe pajisjet e sigurisë tek punonjësit e tjerë. f) Manovrojnë pajisje të ndryshme që prodhojnë produkte dhe nënprodukte të produkteve të para. g) Montojnë pajisjet dhe materialet sipas procedurës së përcaktuar për të prodhuar produktin final. h) Kryejnë teste laboratorike dhe shënojnë rezultatet në regjistrat përkatës. i) Përgatisin preventivë të detajuar të sasive dhe kostove të materialeve dhe punës së nevojshme për kryerjen e punës me saktësi dhe efikasitet. j) Monitorojnë aspektet teknike, rregullatore dhe ato të sigurisë së ndërtimit, instalimit, manovrimit, mirëmbajtjes dhe riparimit të materialeve dhe pajisjeve. k) Ndihmojnë në dizenjimin dhe planifikimin e materialeve, metodave dhe planeve të punës. l) Respektojnë politikat e brendshme të punës dhe procedurat e hartuara nga Institucioni. m) Zbatojnë kodin e etikës të miratuar nga drejtuesit. n) Zbatojnë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit. o) Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.*

Kërkesat për punësim: a. Zakonisht kërkohet të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale; në disa raste një diplomë nga një shkollë e mesme e përgjithshme dhe eksperiencë pune disa vjeçare është gjithashtu e vlefshme.

Manovratorët (drejtuesit e makinerive të rënda eksavatorit/ fadromës, makinave ngjësëse dhe të asfaltimit) dhe shoferat e kamionit (Grupi-njësi (Profesioni) “Shoferë të makinave të rënda dhe kamionëve” Kodi i profesionit: 8332)

Kërkesat për punësim a. Të jetë e/i pajisur me leje drejtimi të nivelit përkatës. b. Zakonisht kërkohet përfundimi i një shkolle profesionale në këtë fushë. c. Të ketë kryer një kurs formimi profesional për këtë profesion. d. Të jetë e/i aftë fizikisht dhe mendërisht.

2.3.5 Operatorët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

2.3.5/a -1 (nje) punonjes të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqese kontrate pune, certifikaten përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

2.3.5/b -1 (nje) Punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqese kontrate pune, certifikaten përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

2.3.5/c -2 (dy) punonjes të trajnuar për punime në lartësi të cilët të jenë të pajisur me certifikatë “Për punime në lartësi”. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqese kontrate pune dhe certifikaten përkatëse ose dëshmi nga institucione të akredituara si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën **3 (tre)** muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit.

23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ligjin nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” date 10.09.1998 i ndryshuar

dhe me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Njësia e Prokurimit mban në konsideratë se shkolla është një objekt relativisht i lartë dhe punonjësit do të punojnë në skela në lartësi, ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të trajnuar për punime në lartësi me qëllim shmangien e aksidenteve në punë.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe

parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se **55 (pesëdhjetë e pesë)** punonjës të siguruar për 3 (tre) mujorin e fundit (duke përfshirë edhe stafin teknik të sipërcituar dhe shoferat /manovratorët). Për t'a vërtetuar këtë duhet të paraqesë :

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore.

- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është vendosur bazuar në sasinë e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithsej **65 000 orë pune punëtori +pune makineri**, për të cilat nevojiten 41 punonjës, ku përfshirë dhe stafin teknik nevojiten në total të paktën **55 (pesëdhjetë e pesë) punonjës**.

			Ore totale punetori	63 439,48	Ore totale makineri	1 460,00
Ore pune ne total per kryerjen e punimeve Referuar Normatives sipas Manualit te Ndertimit			64 899,48			
Total I oreve te punes per kryerjen e punimeve sipas grafikut, 9 Muaj* 22 dite pune * 8 ore			1584			
Numri total i fuqise punetore per kryerjen e punimeve			40,97189432		41 Puntor	

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues ≥ 18 ton	copë 2	Në pronësi ose me qira
Vinc kulle 4-6 T me manovrator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Fadrome me goma	copë 1	Në pronësi ose me qira
Ekskavator 1.0 m3	copë 1	Në pronësi ose me qira
Grejder	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobot	copë 1	Në pronësi ose me qira
Rul (kompresor) me vibrim	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vibrator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vibrator sipërfaqësor	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autobitumatriçe	copë 1	Në pronësi ose me qira/ Kontratë furnizimi
Asfaltoshtuese	copë 1	Në pronësi ose me qira/ Kontratë furnizimi
Betonjere 250 liter	copë 1	Në pronësi ose me qira
Vinç eskavator,	copë 1	Në pronësi ose me qira/Kontratë furnizimi
Trapano Elektrike	copë 1	Në pronësi
Matrapik	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri 5 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Autovinc deri 2,5 ton	copë 1	Në pronësi ose me qira
Skelë inventar + rrjetë rrethimi	Mbi 500 m2	Në pronësi ose me qira
Gazogjen 1 m3/ore		Në pronësi
Elektrosaldatrice	copë 1	Në pronësi ose me qira
Kokore	copë 55	Në pronësi
Pompë suvatimi	copë 1	Në pronësi ose me qira
Gjenerator	copë 1	Në pronësi ose me qira
Depozite uji (kapaciteti minimal 1000 litra)	copë 1	Në pronësi ose me qira
Jelekë	copë 55	Në pronësi
Tabela sinjalizuese	copë 10	Në pronësi
Kuti ndihme e shpejtë	copë 5	Në pronësi
Fikëse zjarri të lëvizshme	copë 5	Në pronësi
Prozhektorë ndriçimi natën	copë 3	Në pronësi

Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:
 - a) Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);

- b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
- c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
- d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- e) Liçencë transporti;
- f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
- g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij
 - Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:
 - a) Kontrata e qerasë
 - b) Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);
 - c) Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)
 - d) Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
 - e) Liçencë transporti (për transport mallrash për të tretë dhe me qera);
 - f) Çertifikatë transporti nga njësia vendore;
 - g) Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)
- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.
- Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak s'kualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.
- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht.

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 18 ton** i referohet të gjitha analizave për transportin e materialit si dhe numrin 2 (dy) kamion i referohet sasisë dhe volumeve në preventiv.

- **Grejder** i referohet analizës 3.212/b, (një) grejder i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Autobot** i referohet analizave 3.212/b, kurse numri 1 (një) autobot i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune dhe volumeve në preventiv.

- **Rrul (kompresor) me vibrim** i referohet analizave 3.216/1, 3.221/1, 3.212/b, kurse numri 1 (një) Rrul (kompresor) me vibrim i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- **Autobitumatriçe** i referohet analizave, 3.226/1, 3.221/2 kurse numri 1 (një) autobitumatriçe i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- **Asfaltoshtruese** i referohet analizave 3.226/1, 3.221/2 kurse numri 1 (një) asfaltoshtruese i referohet numrit minimal për kryrjen e kësaj pune.

- **Mjetet e tjera që kërkohen** i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganzative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i paisur me:

- Licence e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ky kriter është vendosur

bazuar në Ligjin nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe referuar raportit të vleresimit të ndikimit në mjedis, raportit teknik dhe Specifikimeve teknike të projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit të kontrates, metodat e punës që duhet të aplikohen nga zbatuesi duhet të synojnë në minimizimin ose nëse është e mundur në ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit dhe duhet të tregojë një kujdes maksimal në transportin e materialeve me qëllim mbrojtjen maksimale të mjedisit.

2.3.9 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë furnizimi për materialet si me poshtë:

- **Materialet Elektrike**

- **Materialet Hidraulike**

- **Bojrat dhe Gipsin**

- **Materiale termoizolimi**

- **Materiale hidroizoluese**

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Gjithashtu duhet të paraqesë iso 9001, katalog, deshmi të testimeve zyrtare.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter vendoset bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rëndësi se vecante të objektit të prokurimit, duke marrë në konsideratë se godina është një objekt civil që shfrytëzohet nga nxënësit e shkolles.

Megjithatë punimet do të kryhen në një objekt që kërkon kujdes të veçantë për shkak të frekuentimit nga nxënësit e shkolles shfaqet e nevojshme që për mallrat që do të perdoren në realizimin e punimeve, Autoriteti Kontraktor të garantohet që këto mallra furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar dhe në cilësi të duhur.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- ISO 9001:2015 **Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë**

- ISO 14001:2015 **Sistemet e Menaxhimit Mjedisor**

- ISO 45001:2023 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë. Certifikatat e lëshuara nga organizma të pa akredituara do të konsiderohen kusht skualifikimi.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2023 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Do të organizohet një vizitë në kantier 2 ditë para zhvillimit të tenderit në orën 10:00 pranë Autoritetit Kontraktor për të paraqitur mostrat e pllaka mermeri, porcelanat, materiale hidraulike, elektrike, me raport testimet perkatese, si dhe shoqeruar me Certifikatat ISO 9001 të prodhimit, Operatorët e interesuar Ekonomik Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shpeshë e shpjegime ku dhe do të pajisen me vertetim nga insitucioni (mosparaqitja është kusht skualifikimi). Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rremë do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku parashikohet se Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.

Shënim: Për çdo emërtim marke apo cilësie të shënuar në preventivin e punimeve do të pranohet edhe ekuivalenti i tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia përgjegjëse ka hartuar/konfirmuar specifikimet teknike, ku janë shprehur qartë kërkesat AK për realizimin e kontratës.

Njësia përgjegjëse në specifikimet teknike argumenton se nuk ka përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Referuar projektit dhe preventivit, si dhe në bazë të llogaritjeve nga specialisti i fushës janë përcaktuar kriteret e mësipërme. Cdo kriter tjetër i vendosur në DST nuk është përgjegjësi e imja si Anëtare e Njesisë së Prokurimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi: *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës dhe shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve, bazuar në VKM-në të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim*

NJËSIA E PROKURIMIT